



BULETIN MUJOR

PRILL 2026



PËRMBAJTJA

- Shqipëria organizon International Girls in ICT Day 2026
- Cybersecurity Talent Club vijon takimet gjatë muajit prill
- AKSK dhe ITU thellojnë partneritetin për sigurinë kibernetike
- Rritja e kapaciteteve për mbrojtjen e infrastrukturave kritike
- Ndërgjegjësim për sigurinë e fëmijëve në mjedisin digjital

Shqipëria organizon International Girls in ICT Day 2026



Shqipëria u përzgjedh për të organizuar aktivitetin ndërkombëtar "International Girls in ICT Day 2026", një iniciativë globale e International Telecommunication Union (ITU), me fokus promovimin e përfshirjes së vajzave dhe grave në teknologji. Aktiviteti u zhvillua në Tiranë nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë. Gjatë aktivitetit u trajtuan tema si inteligjenca artificiale, siguria kibernetike dhe përfshirja gjinore në teknologji, duke theksuar rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta dhe fuqizimit të vajzave për të qenë pjesë aktive në ndërtimin e së ardhmes digjitale.



Cybersecurity Talent Club vijon takimet gjatë muajit prill

Takimet e Cybersecurity Talent Club kanë vijuar edhe gjatë muajit prill, duke ruajtur fokusin në zhvillimin e aftësive praktike dhe përfshirjen aktive të të rinjve në fushën e sigurisë kibernetike. Përmes sesioneve interaktive, pjesëmarrësit kanë patur mundësinë të thellojnë njohuritë dhe të diskutojnë mbi sfida reale të mjedisit digjital.

Gjatë këtyre takimeve, u vu theksi te zhvillimi i ideve dhe orientimi i tyre drejt zgjidhjeve konkrete, përmes bashkëpunimit dhe shkëmbimit të mendimeve me ekspertë të fushës.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039

AKSK dhe ITU thellojnë partneritetin për sigurinë kibernetike

Në kuadër të International Girls in ICT Day 2026, Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, Bledar Kazia, priti në një takim Drejtorin e International Telecommunication Union (ITU), Cosmas Zavazava. Gjatë takimit u vlerësua bashkëpunimi i deritanishëm dhe u diskutua mbi vijimësinë e partneritetit në forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e sigurisë kibernetike.

Në vijim të vizitës në Tiranë, u zhvilluan edhe takime të tjera institucionale, duke rikonfirmuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mbështetjen për iniciativa që nxisin përfshirjen në teknologji. AKSK mbetet i angazhuar për të forcuar më tej partneritetet strategjike në funksion të një mjedisi digjital të sigurt në vend.



Rritja e kapaciteteve për mbrojtjen e infrastrukturave kritike

Gjatë muajit prill vijuan takimet me përfaqësuesit e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, me fokus forcimin e masave të sigurisë kibernetike dhe rritjen e gatishmërisë ndaj incidenteve. Përmes këtyre sesioneve u trajtuan çështje që lidhen me menaxhimin e rrezikut, identifikimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve, si dhe përmirësimin e praktikave të sigurisë.

Takimet shërbyen si një hapësirë për shkëmbimin e përvojave dhe adresimin e sfidave konkrete, duke synuar rritjen e qëndrueshmërisë kibernetike dhe koordinimit ndërinstitucional në mbrojtje të infrastrukturave kritike në vend.

Ndërgjegjësim për sigurinë e fëmijëve në mjedisin digjital

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi një takim ndërgjegjësuës me nxënësit e shkollës "Klodian Tanushi" në Tiranë, mbi sigurinë e tyre në mjedisin digjital. Aktiviteti mblodhi edhe përfaqësues të mbrojtjes së fëmijëve, ASHDMF dhe psikologun e shkollës, duke sjellë një qasje të integruar mes sigurisë digjitale dhe mirëqenies emocionale.

Gjatë sesionit u trajtuan rreziqet kryesore online, si bullizmi në internet, kontaktet e panjohura dhe shpërndarja e të dhënave personale, si dhe mënyrat për t'i identifikuar dhe raportuar ato. Ky takim është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe ndërtimin e një kulture të sigurisë digjitale.

